



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 64 par.2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, nenit 11 të Rregullores mbi transparencën në Komunën e Lipjanit 15Nr.000-79233 e datës 20.12.2019 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Kryetari i Komunës nxjerr,

**VENDIM**  
**MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT-RREGULLOREN PËR**  
**MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT**

**Neni 1**

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt-Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.

**Neni 2**

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt-Rregullore mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit ose në email adresën [vlora.r.krasniqi@rks-gov.net](mailto:vlora.r.krasniqi@rks-gov.net) më së largu me datë 03.09.2020.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 352-33466  
Lipjan, më 04-08 2020

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

